



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

P.nr.344/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përberë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare, Mejreme Memaj e Agim Maliqi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale të dënuarit I. Sh., nga fshati Ll., komuna e D., për shkak të veprës penale shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore, parashikuar me nenin 318 par.2 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën e mbrojtësit të dënuarit për mbrojtje të ligjshmërisë, avokatit Selman Bogiqi, të paraqitur kundër aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm, P.nr.2169/2016 datë 13 korrik 2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me 1 gusht 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës së mbrojtësit të dënuarit I. Sh. për mbrojtje të ligjshmërisë, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm, P.nr.2169/2016 datë 13 korrik 2023, dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.1321/2023 datë 20 dhjetor 2023, ashtu që Gjykata Supreme e Kosovës të dënuarin me shënim personale si në shkresa të lëndës konform dispozitës së nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPP e liron nga akuza sepse:

“Me tepër se tri vite prej 30.07.2011 deri me 30.07.2014, në kohë të papërcaktuar në pikën kufitare në V., komuna e P., me qëllim që vetes apo personit tjetër t’i mundësoj shmangien nga pagesa e tarifave tatimore doganore apo tarifave të tjera ose detyrimeve doganore që paguhen me rastin e importimit apo eksportimit të mallrave duke i paraqitur doganës dokumente të rrejshme lidhur me cilësinë apo karakteristikat tjera të mallit, në atë mënyrë që në emër të kompanisë importuese “G. G. SHPK”, ka importuar vaj lule dielli të përpunuar “...”, nga eksportuesi “...”, ku gjatë këtij importi është prezantuar çertifikata e origjinës së mallit (...), ku malli-vaj luledielli i përpunuar “...”, deklarohet si mall me origjinë nga Sh., me të cilat veprime i pandehuri me qëllim që të shmangë tarifën e obliguar doganore prezanton “...”, ashtu që sektori i kontrollit pas importuesve ka vërtetuar se vaji i importuar nuk përfiton origjinën e Shqipërisë, ka aplikuar taksat doganore dhe TSH-në në taksën doganore dhe me këtë rast i është shmangë pagesës së taksës doganore, e cila është 10% nga vlera e mallit, si dhe taksën e TVSH-së mbi doganën (16% nga 10%), e me këtë rast i është shmangë tarifave të detyrueshme doganore në shumë prej 24.067.34€

-me çka kishte për kryer veprën penale shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore, parashikuar me nenin 318 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së”.

-për shkak se nuk është provuar se e ka kryer veprën penale.

Shpenzimet e procedurës penale i ngarkohen mjeteve buxhetore të Gjykatës.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i përgjithshëm, P.nr.2169/2016 datë 13 korrik 2023, i pandehuri I. Sh. është shpall fajtor për veprën penale shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore, parashikuar me nenin 318 par.2 lidhur me par.1 të KPRK , për të cilën është gjykuar me dënim me kusht, ashtu që i është caktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muajve, dhe është urdhëruar që ky dënim mos të ekzekutohet me kusht që i pandehuri në afat prej një (1) vit pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të mos krye vepër penale, dhe dënim me gjobë në shumë prej dyqind (200)€, të cilin dënim është obliguar që ta paguaj në afat prej 30 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në rast se dënimin me gjobë i pandehuri nuk mund ta paguajë apo nuk dëshiron ta paguajë i njëjti do t'i zëvendësohet me burgim, ashtu që në një ditë burgimi do t'i llogariten 20€ të gjobës. Përfaqësuesi i të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Në procedurën ankimore sipas ankesës së Prokurorit dhe mbrojtësit të pandehurit Gjykata e Apelit, duke vendosur përkitazi me ankesat me aktgjykimin PA1.nr.1321/2023 datë 20 dhjetor 2023, e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit avokati Selmon Bogiqi, për shkak të shkeljeve të esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelës së ligjit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në vendimin gjyqësor, me propozim që kërkesa të aprovohet dhe aktgjykimet të ndryshohen ashtu që i dënuari të lirohet nga akuza apo të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Prokurori i Shtetit me parashtresën me shkrim KMLP.II.nr.198/2024 datë 6 qershor 2024, ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoj shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPP, vlerësoj pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

Kërkesa është e bazuar

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme me të drejtë pretendohet në kërkesë se me aktgjykimet e kundër të cilave është paraqitur kërkesa është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit, kur ai është shpallur fajtor dhe është gjykuar për veprën penale shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore, parashikuar me nenin 318 par.2 lidhur me par.1 të KPRK.

Nga shkresat e lëndës rezulton se i dënuari I. Sh. me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm, P.nr.2169/2016 datë 13 korrik 2023, është shpallur fajtor për veprën penale të lartcekur, për shkak se “ me tepër se tri vite prej 30.07.2011 deri me 30.07.2014, në kohë të papërcaktuar, në pikën kufitare në V.- komuna e P.,

me qellim që vetes apo personit tjetër t'i mundësoj shmangie nga pagesa e tarifave tatimore doganore apo tarifave tjera ose detyrimeve doganore që paguhen me rastin e importimit apo eksportimit të mallrave, duke i paraqitur doganës dokumente të rrejshme lidhur me cilësinë apo karakteristikat tjera të mallit, në atë mënyrë që i pandehuri në emër të kompanisë importuese "...", ka importuar vaj lule dielli të përpunuara "...", nga eksportuesi "...", ku gjatë këtij importi është prezantuar certifikata e origjinës së mallit (...)", ku malli vaj luledielli i përpunuar "...", deklarohet si mall nga origjinë nga Shqipëria, me të cilat veprime i pandehuri me qellim që të shmang tarifën e obliguar doganore prezanton "...", ashtu që sektori i kontrollit pas importues ka vërtetuar se vaji i importuar nuk përfiton origjinën e Shqipërisë, ka aplikuar taksat doganore dhe TVSH-në në taksën doganore dhe me këtë rast është i është shmangë pagesës së taksës doganore, e cila është 10% nga vlera e mallit, si dhe taksës së TVSH-së mbi doganën (16% nga 10%), dhe me këtë rast i është shmangë tarifave të detyrueshme doganore në shumë prej 24.067.34€".

Nga shkresat e lëndës rezultojnë se subjekti afarist "...", pronar i të cilës është i dënuari I. Sh., gjatë viteve 2011-2014 ka importuar vaj luledielli të përpunuar "...", nga eksportuesi "...". Gjatë këtij importi është prezantuar certifikata e origjinës së mallit (...), ku malli vaj luledielli i përpunuar "...", deklarohet si mall me origjinë nga Sh.. Dokumenti i origjinës (...) është dokument i cili dëshmon origjinën e një malli. Ky dokument lëshohet nga doganat e shteteve me kërkesën e prodhuesit vendor dhe shërben nëse malli eksportohet jashtë nga shteti me qellim që të dëshmohet origjina e mallit të prodhuar.

Rezultojnë se sektori i kontrollit pas importues i Doganës së Kosovës ka dyshuar në deklarimin e mallit nga ana e kompanisë importuese "...". Meqë kanë dyshuar në origjinalitetin e dokumenteve të origjinës (...) për import të vajit ushqimor "...", i kanë bërë kërkesë autoriteteve të Sh. për konfirmimin e të gjitha dokumenteve të origjinës që kanë të bëjnë me importin e vajit "...", në Kosovë. Autoritetet e Sh. i janë përgjigjur kërkesës me 17.06.2014, në të cilën përgjigje theksojnë se certifikatat janë autentike por nuk janë lëshuar në mënyrë të rregullt dhe mallrat e mbuluara në to nuk plotësojnë kushtet për përfitimin e trajtimit tarifor favorizues. Bazuar në këtë përgjigje sektori i kontrollit pas importues ka bërë auditimin e kompanisë dhe ka lëshuar aktvendimin 05.1/491 datë 28.08.2014 me të cilin e obligon kompaninë "..."- që të paguaj obligimin doganor në vlerë prej 50.483.55€ duke bërë ndryshimin në 19 importe të mallit va ushqimor "...".

I dënuari në ankesën e ushtruar ndaj vendimit të lartcekur ka kërkuar që të behet ekspertizë e saktësisë së dokumenteve. Në emër të kërkesës së Doganës së Kosovës për verifikimin e dokumenteve të origjinës të paraqitur nga sektori për rishqyrtim të vendimeve dogana e Sh. në tri raste ka dhënë përgjigje. Në përgjigjen e dhënë me 25.11.2014 theksohet se tetë dokumente të origjinës janë autentike dhe artikujt e përshkruara në to i plotësojnë kushtet për tu konsideruar si mallra me origjinë preferenciale të Sh.. Në përgjigjen e dhënë me 30.01.2015 kanë deklaruar se për tetë certifikata të lëshuar në vitin 2011 nuk mund të kryejnë verifikime ngase ka kaluar afati tre vjeçar për ruajtjen e vërtetimit të origjinës. Në përgjigjen e dhënë me 11.05.2015 kanë deklaruar se tetë certifikata të lëshuara gjatë vitit 2012 janë autentike, por artikujt e përshkruara në to nuk i plotësojnë kushtet për tu konsideruar si mallra me origjinë të Sh.. Sektori i kontrollit pas importues me aktvendimin përfundimtar 07.3/1273, 1323 datë 19.06.2015 e obligon kompaninë në shumë prej 25.067.33€, për të cilën shumë dhe dokumente të origjinës edhe akuzohet me akuzë i dënuari, të cilën edhe e ka paguar i dënuari.

Në këtë çështje juridiko penale del se janë bërë disa ekspertiza financiare. Sipas ekspertizës financiare të urdhëruar nga Dogana e Kosovës dhe kryer nga eksperti B. I. del se i dënuari I.

Sh. - pronar i kompanisë "...", i është shmangur pagesave të tarifave të detyruara doganore në shumë prej 24.067.34€.

Të njëjtin mendim e ka dhënë edhe eksperti financiar R. F. (ekspertizë kjo e urdhëruar nga prokuroria), të cilin e ka mbështet edhe në shqyrtimin gjyqësor. Kurse, sipas ekspertizës së ekspertit R. B. (e urdhëruar nga mbrojtja) ngarkesa me obligime shtesë e subjektit "...", në shumë prej 24.069.35€ nuk ka mbështetje për faktin se çertifikata e origjinës së mallit preferencial shqiptar "...", në kohën e zhdoganimit të mallit ka qenë e vlefshme, por edhe tani është e vlefshme, do të thotë që asnjëherë gjer me tani nuk janë anuluar-shfuqizuar si e pavlefshme nga organi që e ka lëshuar, pra dogana shqiptare. Ndërsa, dogana e Kosovës me asnjë dokument nuk ka arrite të provojë se malli kontestues, pra, vaji i lulediellit "...", i furnizuar nga subjekti prodhues "...", të ketë prejardhje tjetër nga ajo që vërtetohet me "...". Eksperti këtë mendim e ka mbështet edhe në shqyrtimin gjyqësor.

Meqë dy ekspertizat e fundit ishin kundërthënëse njëra me tjetrën gjykata ka urdhëruar super ekspertizë. Sipas super ekspertizës të kryer nga grupi prej tre eksperteve respektivisht konkludimit të tyre del se me rastin e importit të mallit vaj "...", nga Sh. gjatë vitit 2011-2012 në disa raste ka pas parregullsi, pasi që lidhur me dokumentet e origjinës së mallit është gjetur se janë të parregullta, meqenëse produkti i importuar nuk i ka plotësuar kushtet për tu trajtuar si mall me origjinë nga Sh.. Çertifikatat "...", në tetë raste të importeve kanë rezultuar të jenë autentike, por artikujt e përshkruar në kutinë e tyre nuk i kanë plotësuar kushtet për tu konsideruar mallra me origjinë shqiptare. Në këtë mënyrë për tetë importe ka pas shmangie nga pagesat e detyrueshme doganore në shumë prej 24.067.34€. Nga shkresat e lëndës nuk ka dëshmi se cilat do ta implikonin stafin përgjegjës të importuesit "...", lidhur me parregullsitë e dokumenteve të origjinës së mallit të importuar, të cilat sipas konstatimit të mëvonshëm të Doganës së Sh. nuk kanë qenë në pajtim me rregullat për të përfituar origjinën preferenciale të mallit të importuar. Kompania "...", ka paguar detyrimet doganore në shumë prej 24.067.34€. Ekspertet këtë mendim e kanë mbështetur edhe në shqyrtimin gjyqësor.

Gjykata e shkallës së parë bazuar në këtë gjendje të fakteve çuditërisht duke ia falur besimin të gjitha ekspertizave vjen në konkludim se i dënuari është përgjegjës penalisht për veprën penale për të cilën është akuzuar, të cilin konkludim e mbështet edhe gjykata e shkallës së dytë.

Mirëpo, duke pasur parasysh këtë gjendje të çështjes, sipas vlerësimit të kësaj gjykate konkludimi i gjykatave se i dënuari është penalisht përgjegjës nuk është i bazuar, për këtë arsye:

Me dispozitën e nenit 318 par.1 të KPPK, parashihet "kushdo që me qellim që vetes apo personit tjetër t'i mundësojë shmangien nga pagesa e tarifave tatimore doganore apo tarifave tjera ose detyrimeve doganore që paguhen me rastin e importimit apo eksportimit të mallrave, ose nëse doganës i paraqet dokument të rrejshëm lidhur me prejardhjen, vlerën, sasinë, cilësinë, llojin apo karakteristikat tjera të mallit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet".

Pra, kjo vepër kryhet në dy mënyra me mundësimin e shmangies nga pagesa e tarifave tatimore doganore apo tarifave tjera ose detyrimeve doganore që paguhen me rastin e importimit apo eksportimit të mallrave dhe nëse doganës i paraqet dokument të rrejshme lidhur me prejardhjen, vlerën, sasinë, cilësinë, llojin apo karakteristikat tjera të mallit.

I dënuari është akuzuar se i ka paraqitur doganës dokumente të rrejshme - certifikata e origjinës së mallit (...), por, bazuar në provat e administruara sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk argumentohet fakti se i dënuari ka prezantuar dokumente të rrejshme, respektivisht nuk

argumentohet fakti se i dënuari e ka punuar dokumentin (certifikatën e origjinës së mallit) si të rremë apo ta ketë ndryshuar apo ta ketë përdor si të rreme. Pastaj, bëhet fjalë për një dokument që e kanë lëshuar autoritet e Sh. (doganat), të cilat nuk e vejnë në pikëpyetje autenticitetin (origjinalin) e dokumenteve, e përveç kësaj dy ekspertizat e fundit nuk e implikojnë të dënuarin në përfshirjen e tij në parregullsitë e dokumenteve të origjinës së mallit të importuar, pra, nuk është argumentuar se i dënuari me veprimet e tij ka konsumuar elementet e kësaj vepre penale, prandaj me të drejtë pretendohet në kërkesë se konkludimet e gjykatave janë të gabuara.

Për arsyet e lartcekura kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret vjen në shprehje parimi “in dubio pro reo”, prandaj i ndryshoj aktgjykimet e instancave me të ultë, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke e liruar të dënuarin nga akuza për këtë vepër penale.

Nga sa u tha me lartë e konform dispozitës së nenit 438 par.1 pika 1.1 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.344/2024 datë 1 gusht 2024

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit
Valdete Daka